

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJËDIS



**FABRIKA PËR PRODHIMIN, KONZERVIMIN E FRUTAVE, PËRIMEVE SI DHE
PRODHIMI I KETCHAPIT DHE MËRMELATËS, ZONA INDUSTRIALE RRUGA
TIRANA p.n PRIZREN.**

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

“ABI&ELIF” sh.p.k

**FABRIKA PËR PRODHIMIN, KONZERVIMIN E FRUTAVE DHE PËRIMEVE SI DHE
PRODHIMI I KETCHAPIT DHE MËRMELATËS, PRIZREN**



Deklarim:

Vlera investive: FABRIKA PËR PRODHIMIN, KONZERVIMIN E FRUTAVE, PËRIMEVE SI DHE PRODHIMI I KETCHAPIT DHE MËRMELATËS, ABI&ELIF sh.p.k. ZONA INDUSTRIALE RRUGA TIRANA p.n PRIZREN, **ka qenë 320,000.00 (euro)**

Investitori :	<p style="text-align: center;">INVESTITORI: "ABI & ELIF" SH.P.K. PRIZREN</p> 
Emërtimi i projektit	<p style="text-align: center;">Raport</p> <p style="text-align: center;">I Vlerësimit të Ndikimit pwr fabrikwn per prodhimin,kozervimin e frutave he perimeve si dhe prodhimin e kechapit dhe mermalatws</p>
Lokacioni :	Prizren
Hartues i Raportit të VNM-s	<p style="text-align: center;">"GJEO-T" SH.P.K Leutrim Frangu</p> 
Hartuesit e Raportit të VNM-s	<ol style="list-style-type: none"> 1. Menderes Halabaku inxh.dipl.i gjeol. 2. Muharrem Salihaj maxhistë I mjedisit 3. Bislim Fetahu maxhistër I shk.teknike 

Prizren, Nëntor 2022

Përmbajtja:

1.0. HYRJE	6
2.0. KORNIZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT.....	11
2.1. Metodologjia e punës	12
3.0. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE I MJEDISIT	13
3.1. Pozita gjeografike e lokacionit	13
3.2. Popullata dhe vendbanimet.....	16
3.3. Lidhjet e komunikacionit	17
3.4. Natyra dhe biodiversiteti.....	18
3.5. Flora dhe vegjetacioni.....	18
3.6. Fauna	19
3.7. Peisazhi	20
4.0. KARAKTERISTIKAT HIDROLOGJIKE.....	21
4.1. RRJETI HIDROGRAFIK.....	22
4.2. KARAKTERISTIKAT KLIMATIKE.....	23
4.3. RESHJET.....	24
4.4. BORA.....	26
4.5. TEMPERATURA E AJRI.....	27
4.6. ERËRAT.....	28
5.0. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE INFRASTRUKTURA.....	28
5.1. Objektivat dhe infrastruktura.....	28
5.2. ZBATIMI I RREGULLAVE TË SIGURIMIT TEKNIK, HIGJENËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT	30
6.0. PROCESI TEKNOLOGJIK.....	31
6.1. Konzërimi i frutave dhe përimëve	34
6.2. Formula e sterilizimit dhe faktorët që ndikojnë në sterilizim.....	35
6.3. Skema e procesit teknologjik i përpunimit dhe konzërimi i frutave dhe përimëve si dhe prodhimi i mermelatës-Kapaciteti.....	37
6.4. Proceset parapërgatitore për përpunimin e pemëve.....	38
7.0. LLOJET E PRODUKTËVE DHE PËRBERJA E TYRE.....	40
8.0. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	51
8.1. Ndikimet në ajër.....	51
8.2. Ndikimet në tokë.....	52

8.3.Ndikimet në ujë.....	52
8.4.Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë.....	53
8.5.Ndikimet në vendbanime dhe popullatë.....	53
8.6.Ndikimet nga zhurma.....	54
8.7.Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	54
9. MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT.....	54
9.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër.....	54
9.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë.....	55
9.3. Masat për mbrojtje nga zhurma.....	56
9.4. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë.....	57
9.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë.....	57
9.6. Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore.....	57
9.7. Menaxhimi i mbeturinave.....	60
10. MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	60
10.1.Monitorimi.....	60
10.2.Raportimi.....	61
11. KONKLUZIONE.....	61
12.LITERATURA.....	63
13. Shtojcat.....	64

HYRJE

Vlera e frutave e perimeve për konsum dhe si lende nistore në industrinë e konservimit dhe kërkesat ndaj tyre njeriu i ka shfrytëzuar frutat dhe perimet si ushqim dhe mjete kuruese që me lindjen e tij. Qysh në lashtësi ai është interesuar për dobinë e tyre, dhe ka kërkuar mënyrat për t'i pasur ato gjithë vitin. Njohuritë e tij për këto çështje janë thelluar dhe plotësuar vazhdimisht. Arritjet e shkencës vërtetojnë lavdinë shekullore të frutave dhe perimeve, dëshmojnë rëndësinë e madhe që kanë ato për jetën e shëndetin e njeriut. Jeta dinamike të cilën përjeton njeriu i sotëm çon në lodhje, veçanërisht te njerëzit që punojnë të tensionuar. Shumë prej tyre përpiqen të shmangin pasojat e lodhjes, duke përdorur mjete stimuluese, si: kafe, çaj, cigare, koka-kola etj. Por asnjë prej këtyre mjeteve nuk shmang pasojat e punës së tensionuar mendore e fizike. Ndikimi pozitiv në organizmin e njeriut i lendeve që përmbajnë frutat dhe perimet e freskëta (vitamina, enzima, kripa minerale etj.) nuk mund të zëvendësohen kurrë me stimulues artificial.. Frutat dhe perimet e freskëta janë ushqim me vlerë të lartë, për shkak të përmbajtjes së lëndëve biologjike aktive.

Pemët dhe perimet	Për 0.47 litra lëng	Kaloriti	Sheqer (g0
Karrota	900ml	352	41
Panxhari	900ml	384	64
Trangulli	1.350ml	192	16
Lakëra	1.120ml	560	24
Molla	900ml	480	96
Spinaqi	1.800ml	384	6
Selino	32 gjethe	192	32
Mango	900ml	576	128
Të gjitha	N/A	390	51

Tabela. 1. Vlera kalorike të pemët dhe perimet


Karakteristikat teknologjike të përbërësve kryesorë të frutave dhe perimeve Për të siguruar një proces teknologjik të rregullt është e domosdoshme të njihet përbërja kimike e frutave dhe perimeve, kjo varet kryesisht nga lloji, kultivari, shkalla e pjekurisë, toka, klima, shërbimet agroteknike etj. Frutat dhe perimet përmbajnë ujë, karbohidrate, kripëra minerale, acide organike, lëndë aromatike, tanina, vitamina, enzimaetj. Proteina dhe lyre përmbajnë farat e tyre. Përbërja kimike e frutave dhe e perimeve e shprehur në përqindje

për 100g produkt, jepet në tabelën me poshtë.

	Ujë	Proteina	Lyrë	Karbohidrate	Acide organike	Kripëra
Fruta	78-82	0,4-1,3	0,1-0,6	7,5	1-3,5	0,2-0,9
Perime	80-96	1,4-6,3	0,1-0,5	4,5-12,8	0,7-1,1	1,02-1,9

Tabela. 2. Përbërja kimike e frutave dhe e perimeve e shprehur në përqindje (%).

Lagështira në frutat dhe perimet uji ndodhet në dy forma: i lirë dhe i lidhur. Luhatjet në kufijtë 78-96%. Roli i tij për organizimin është shumë i madh. Në ujë treten karbohidratet, kripërat minerale, albuminat, hidrovitaminat etj. Përbërsit kimik të fruta - perimeve, përveç ujit, përbëjnë lëndën e thatë, e cila mund të jetë e tretshme dhe e patretshme. Lënda e thatë e tretshme, ose siç quhet ndryshe ekstrakti, përbëhet nga karbohidratet (glukoza, fruktoza, sakarozi etj.), alkoolet polivalente, acidet organike (acidi citrik, tartrik, malik, benzoik, oksalik, salicilik etj.), kripërat minerale dhe organike etj. Karbohidratet. Frutat dhe perimet përmbajnë më shumë glukozë dhe fruktozë, në disa raste dhe sakaroz. Sheqeri i frutave (glukoza dhe fruktoza) përvetohen më lehtë nga organizmi i njeriut sesa sheqeri i perimeve (sakarozi), sepse është në trajtë të invertuar. Glukoza është pa ngjyrë dhe kristalizohet e fermentohet shpejt. Fruktoza tretet shumë mirë në ujë në trajtë shurupi të trashë, por kristalizohet dhe fermentohet më me vështirësi se glukoza. Tretësira ujore e sakarozit në të nxehtë, në prani të acideve organike e inorganike invertohet në glukozë dhe fruktozë (sheqer invert). Nxitës për këtë reaksion është enzima invertazë.



Shkalla e ëmbëlsisë së këtyre tre sheqernave është si më poshtë: më e ëmbël është fruktoza pastaj vjen glukoza dhe në fund sakarozi. Amidoni. $(\text{C}_6\text{H}_{10}\text{O}_5)_n$ gjendet në drithëra dhe në shumë perime (patate, bizele etj.). Nuk tretet me ujë të ftohtë, gjatë zierjes peltëzohet. Sheqeri i mashurkave dhe i bizeleve të njoma, nën veprimin e enzimave polimerizohet në amidon. Pra rritet sasia e amidonit në kurriz të sheqerit invert. Kjo dukuri vërehet të konservat e mashurkave ose bizeleve të njoma, nëse këto nuk përpunohen shpejtë. Lëngu

i tyre është i trubullt, për shkak të amidonit të përftuar. Pra cilësia e këtyre konservave është e dobët. Celuloza. $(C_6H_{10}O_5)_n$ Sasia e celulozës në fruta e perime varet nga lloji, pjesa anatomike dhe shkalla e pjekurisë. Megjithëse e papërvetueshme, roli i saj për organizmin është i madhë, pasi celuloza nxit peristalike zorrëve. Pektinat gjenden më shumë në lëkurën dhe zemrën e frutave, p.sh: të mollës, dardhës, ftoit, portokallit etj. Pektina, në mjedis acid, me sheëerin formon xhele (pelte). Kjo veti e saj shfrytëzohet në industrinë e konservimit për prodhimin e marmalatës, reçel konfiturës, prevedesë 9 etj Xhelimi shprehet në gradë. Me gradë xhelim do të kuptojmë sesa kilogram sheqeri lidhet me 1kg pektinë. Shembull. Sa kilogram pektinë 120°-she duhen përdoeue për prodhimin e reçelit me 62% lëndë të thatë: Pra, në 100kg reçel duhet të hedhim 0,516 kg pektinë. Lëndët tanine. Prania e tyre ndihet lehtë nga shija karakteristike që të rrudhin gjuhën. Taninat e tretshme në ujë ndikojnë mjaftë në cilësinë e konservave të frutave. Ato oksidohen shumë shpejtë, për pasojë tulli i frutave nxihet. Kjo dukuri e dëmshme duhet shmangur duke frenuar veprimin e enzimave që e shkaktojnë (teknoloksidaza dhe politeknoloksidaza). Prandaj frutat e qëruara ose të prera, menjëherë trajtohen me dioksid squfuri ose tretësirë të klorurit të natriumit, pastaj shpëlahen me ujë të rrjedhshëm. Më shumë taninë përmbajnë mollët, ftonjët, shegët, dardhat, qershitë, vishnjët, pjeshkët etj., dhe veçanarishtë kur këto vilen në fazën e pjekurisë teknike (ende të gjelbra dhe të papjekura). Acide organike kryesore janë acidi malik (i mollës), citrik (i limonit), tatrik (i rrushit). Gjenden dhe acide të tjera si salicilik, benzoik dhe oksalik. Acidet organike, sasi e të cilave arrin 6-8%, ndikojnë në shijen e frutave e perimeve, për pasojë dhe në teknologjinë e përpunimit të tyre. Sasia e acidit citrik në agrume, sidomos te limoni, arrin 6-8%. Vajrat eterike u japin aromën karakteristike frutave dhe perimeve. Të pasura me vajra eterike janë mollët, pjeshkat, agrumet, majdanozi, qepa dhe hudhra. Sasia e tyre varet nga kushtet klimatike. Në vendet me klimë të nxehtë, prania e vajrave eterike ndjehet shumë. Lëndët ngjyuese në frutat dhe perimet janë të shumta dhe të shumëllojshme. Më të rëndësishmet janë: Klorofila, që u jep ngjyrën e gjelbër frutave dhe perimeve. Nuk tretet në ujë. Merr pjesë në procesin e fotosintezës gjatë të cilit përfitohet sheqer dhe komponime të tjera organike të frutat e perimet. Për të ruajtur ngjyrën e gjelbër, perimet që konservohen, duhet të përpunohen sa më të freskëta, në temperaturë nën 100°C, dhe të trajtohen me

tretësirë të dobët bazike. Karotina, që u jep ngjyrë të verdhë portokalleve, karotave, pjeshkëve, kajsive etj. Nga shpërbërja e karotinës përftohen vitamina A. Likopina, që u jep ngjyrën e kuqe, domateve dhe në lëkurën e frutave. Antocianet, lëndë ngjyruese, që gjenden në lëngunqelizor të frutave dhe në lëkurë, kanë rëndësi të madhe për organizmin. Ato gjenden në lëkurën e rrushit, kumbullave, pjeshkëve dhe në lëkurë, kanë rëndësi të madhe për organizmin. Ato gjenden në lëkurën e rrushit, kumbllave, pjeshkave dhe në tulin e qershive, vishnjeve etj. Ngjyra e antocianeve ndryshon nën veprimin e 10 temperaturës dhe të pH-it. Në mjedis acid ato kanë ngjyrë të kuqe, kurse në mjedisin bazik marrin ngjyrë blu. Kripërat minerale. Në krahasim me frutat, perimet përmbajnë më shumë kripëra minerale. Spinaqi, karotat, domatet, lakra përmbajnë shumë më tepër kripëra minerale se vishnjët kajsitë, pjeshkët, kumbullat et., përmbajtja e proteinave dhe lyrave është e papërfillshme, me përjashtim të bimëve vajore (ulliri, lule dielli etj.) dhe atyre eterovajore. Glikozidet kanë shije të hidhur tepër të ndjeshme. Glikozidet që gjenden më shumë në fruta, perime janë amigdalina dhe solanina. Amigdalina gjendet në farën e shumicës së frutave. Tek bajamet e hidhura sasia e amigdalines arrin 2,5 - 3% dhe shpesh bëhet shkak për helmime. Solanina gjendet në tubenin e patates dhe në sipërfaqe kur ato marrin ngjyrë të gjelbër. Sasia prej 0,002 - 0,01% e solaninës në patate është normale, mbi këtë kufi patatja merr shije të hidhur, dhe nuk është e përshtatshme për konsum, rrezikon për helmatisje. Vitaminat: Frutat e perimet janë të pasura me vitamina dhe konsiderohen si burimi kryesor i vitaminave. Megjithëse vitaminat nuk janë as burim energjetik as material plastik, roli i tyre për organizimin është i pazëvendësueshëm, sepse mungesa e tyre sjell çrregullime të ndryshme të organizmit. Frutat dhe perimet përmbajnë vitamina të tretëshme në ujë (hidro - vitaminat), si: vitaminë C, B₁, B₂, B₆, B₁₂, PP, K etj. Enzimat ose katalizator biologjikë, luajnë rol të rëndësishëm në teknologjinë e përpunimit të frutave dhe perimeve. Në disa raste veprimi i tyre ndaj lëndës së parë është i dobishëm. I tillë është veprimi i invertazës, që katalizon hidrolizën e sakarozit në glukozë dhe fruktozë. Ose veprimi i α dhe â amilazës, që katalizojnë hidrolizën e amidonit në dekstrinë dhe maltazë. Më tej maltoza nën veprimin e enzimës maltozë shpërbëhet në dy molekula glukozë. Por në shumicën e rastëve veprimi i enzimave sjell dëme. P.sh. enzimata polifenoloksidazë, në prani të oksigjenit të ajrit, oksidon komponimet fenolike të frutave në kinone. Kështu

mollët, dardhët dhe ftonjët e qëruar ose të prerë nxihen nga veprimi i saj. Prandaj gjatë procesit teknologjik të përpunimit të frutave, duhen marrë të gjitha masat, për të ndaluar veprimin e polifenoloksidazës. Një nga mënyrat është trajtimi i tyre në temperatura të larta (përvëlimi).

Fruta	Lagështirë	Sheqer		Sheqer i përgjithshëm	Aciditeti i shperhur në acid malik	Tanina	Pektina	Celulozë	Hi
		I invertuar	Sakaroz						
Mollë	83,40	10,10	0,86	0,96	0,21	-	0,18	1,2	0,33
Dardhë	85,68	8,59	0,91	9,41	0,21	0,02	0,55	0,81	-
Ftua	84,40	9,53	4,02	10,85	1,15	0,66	-	-	0,73
Kajsi	85,88	2,84	6,40	9,24	1,11	1,07	0,70	0,48	0,2
Pjeshkë	84,50	3,66	7,20	10,35	-	0,15	0,93	0,49	0,58
Kumbulla	83,48	4,92	6,70	11,62	0,64	-	-	-	-
Qersh	85,00	9,29	0,08	-	0,80	0,05	0,61	4,71	0,51
Portokalli	85,89	-	-	5,59	1,29	-	0,27	2,31	0,73
Limona	82,33	0,91	0,85	1,80	2,31	0,10	1,04	-	0,64
Mandarina	87,65	-	-	3,49	0,62	-	0,84	0,59	0,47

Tabela.3. Përbërja kimike mesatare e disa frutave (në %)

Perimja	Lagështirë	Lëndë e thatë	Albuminë	Lyra	Karbohidrate	Celulozë	Hi
Qepë	88,17	11,83	1,27	0,14	9,13	0,74	0,54
Hudhër	69,42	30,58	5,58	0,13	22,26	0,88	0,31
Mashurka	89,10	10,90	2,51	0,21	6,22	1,22	0,74
Lakër	90,85	9,15	2,34	0,32	4,52	0,94	0,98
Lulelakër	92,49	7,51	1,60	0,15	4,06	0,95	0,76
Karota	88,10	11,90	1,16	0,27	8,24	1,13	0,93
Trangu	96,57	3,43	0,77	0,13	1,59	0,50	0,45
Spinaq	91,50	8,50	2,69	0,38	2,93	0,68	0,68
Kungull	90,41	9,59	1,15	0,16	6,25	1,26	0,78
Marule	95,04	4,96	1,35	0,24	1,92	0,59	0,86
Majdanoz	84,85	15,55	3,60	0,85	7,10	1,80	1,70

Tabela.4. Përbërja kimike mesatare e disa perimeve (në %)

Frutat dhe perimet gjatë procesit të pjekjes pësojnë ndryshime në përbërjen kimike. Sasia e sheqerit shtohet, kurse amidoni, celuloza dhe acidet pakësohen. Protopektina hidrolizohet, për pasojë shtohet sasia e pektinës së tretshme dhe frutat bëhen më të buta. Në procesin e pjekjes, në fruta dhe perime ndodhin ndryshime në përmbajtjen e vitaminave (të vitaminës C dhe vitaminës A). P.sh. në specin e pjekur, vitamina C dhe A

janë shumë më tepër sesa në specin e papjekur. Prandaj themi se duhet marrë në konsideratë shkalla e pjekurisë së frutave dhe perimeve për t'u shfrytëzuar si lëndë nistore në industrinë e konservimit. Roli i përbërësve kimik të frutave dhe perimeve në përpunimin e tyre është i gjithanshëm. Sasia e acideve që ato përmbajnë ndikon në teknikën e përpunimit. Aciditeti i lartë pengon zhvillimin e baktereve kalbëzuese dhe baktereve në përgjithësi, me përjashtim të myqeve. Aciditeti ndikon si rregullator i kohës së sterilizimit të konservave. Produktet me aciditet të lartë sterilizohen për kohë më të shkurtër. Prandaj konservat e frutave sterilizohen me lehtësi se ato të perimeve. Albuminat, që ndodhen të lidhura me lëngune qelizave, pengojnë daljen e tij jashtë. Kjo është e dukshme te frutat. Prandaj shtrydhja e tyre bëhet duke i lëvizur në temperaturë 70-80°C, që albuminat të koagulojnë. Koagulimi i albuminave shkruftërin strukturën e indeve, i bën këto më poroz. Trubullimi i lëngjëve të frutave e të perimeve shkaktohet nga prania e lëndëve albuminozë. Për të shmangur këtë defekt përdorim tanina, me të cilat përfitohen komponime të patretshme që fundërrojnë. Frutat dhe perimet që thahen, duhet të përmbajnë sa më pak taninë që të mos nxihen. Ngjyra e frutave dhe perimeve ndikon në pamjen e konservave dhe për pasojë në përvetimin e tyre. Zierja për kohë të gjatë i shkatërron antocianet. Prandaj përpunimi i tyre në aparate me sbrazëti, ku ziejnë në temperatura relativisht të ulëta, ka shumë përparsi për ruajtjen e përbërjes kimike të pandryshuar.

2. KORNIZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT

-Bazuar në karakteristikat e fabrikës fabrika për prodhimin, konzervimine frutave dhe perimeve si dhe prodhimi i keqapit dhe mërmelatës, rruga Tirana p.n Prizren, me infrastrukturë përcjellëse dhe sipas projektit (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt është i ndërtuar në vitet e para luftës në Kosovë, është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Nr. 03/ L-214)**, është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar për hartimin e këtij raporti. Shtojca 2 e këtij ligji, paragrafi:

7. Industria ushqimore, Nën paragrafi:

7.2. Paketimi dhe ambalazhimi i produkteve bimore dhe shtazore;

- ✓ Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:
- ✓ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- ✓ Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 03/L-160
- ✓ Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- ✓ Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- ✓ Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- ✓ Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- ✓ Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- ✓ Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110

- Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për te u pajisur me pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

2.1. Metodologjia e Punës

-Për të vlerësuar ndikimin në mjedis (VNM) si dhe për të identifikuar masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, fabrika për prodhimin, konzervimin e frutave dhe përimeve si dhe prodhimi i keqapit dhe mërmelatës, rruga Tirana p.n Prizren, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyre, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme sipas fazave.

Informatat themelore mbi:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis,
- Popullatën dhe vendbanimet në lokacion,

- Karakteristikat hidrologjike, topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit,
- Klima dhe të dhënat meteorologjike,
- Kualiteti i ajrit, ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion,
- Bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit.

Vlerësimi i ndikimeve sipas kritereve në vijim:

- Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit,
- Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti,
- Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës,
- Vlerësimi i përhapjes së ndotjes.

Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, duke u bazuar në rezultatet / të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE I MJEDISIT

3.1. Pozita gjeografike e lokacionit

Fabrika pr perpunimin e qumeshtit "ABI&ELIF" sh.p.k ndodhet në zonen industriale perkatesisht ne rrugen tirana ne qytetin e Prizrenit i cili ndodhet ne pjesën jugore të Republikës së Kosovës në parcelën me Nr. P - 71813068-06939-0 Zk. Prizren, rreth 3 Km larg qendres se qytetit te Prizrenit.

Fabrikea për prodhimin, konzervimine frutave dhe përimeve si dhe prodhimi i keqapit dhe mërmelatës "ABI&ELIF" sh.p.k, është i vendosur në lokacioni e lartcekur ne parcelen me Nr. P - 71813068-06939-0, ne koordinata **N 42° 13' 3"** dhe **E 20° 43' 24"**, ne zonën kadastrale Prizren. Lokacioni bënë pjese ne rrafshin e Dukagjinit, ne pjesen me jugore te tij dhe kufizohet me komuant Gjakove, Rahovec, Suhareke dhe Dragash. Pranë lokacionit-parcelles se fabrikes ne fjale ne nje distance rreth nje kilometer ne pjesen jugore te saj kalon

Lumbardhi i Prizrenit i cili është një nga deget kryesore të lumit Drini dhe i cili buron në malet e Sharrit.



Figura.1. Lokacioni i kompanisë në raport me qytetin dhe Lumbardhin e Prizrenit

Zona në të cilën e ushtron aktivitetin e saj fabrika në fjalë nuk ka ndonjë status të zonës së mbrojtur me ç' rast do të paraqiste kufizime ligjore për zhvillimin e aktivitetit nga kompania në fjalë. Pusi, koordinatat; **N 42° 13' 3"** dhe **E 20° 43' 24"**.

Prizreni me së shpeshti quhet: Ana e Prizrenit, baseni i Prizrenit ose Rrafshi i Dukagjinit. Kufizohet me Komunitetet e Gjakovës, Rahovecit, Therandës, Shtërpçës dhe Sharrit si dhe me Shqipërinë dhe Iliriden. Gjetet në lartësi mbidetare rreth 400 metra dhe disa maje të Sharrit kalojnë lartësinë 2000 m të lartësisë mbidetare. Klima e qytetit është jashtëzakonisht e Llojlojshme. Në viset e ulta për shkak të ndikimit të klimës mesdhetare dhe verave shumë të nxehta të korrurat janë nder të parat në Evropën juglindore me përparësitë e pakrahasueshme për kulturat bujqësore: Hardhia e Rrushit, pemët dhe

perimet. Në viset malore, dominon klima e alpeve, për q'arsye deri në Qershor nëpër gropa mbeten sasi të e dëborës me q'rast në mes të verës mund të zbardhohen majat e maleve. Pozita regjionalo-gjeografike e Prizrenit më së miri mund të shqyrtohet me analizën e pozitës së tij në relacion me Kosovën, rrafshin e Dukagjinit dhe rrafshin e Lumëbardhit. E veçanta a territorit të K. Prizrenit është sepse neper këtë territor kalon Drini i Bardhë si edhe përmes qytetit kalon lumi i njohur me emrin Lumëbardhi i Prizrenit, si dhe disa lumenj me te vogël si Toplluha etj.

Temperatura mesatare e muajit korrik është 22,27 °C, ndërsa e janarit 0.18 °C. Muajt e verës janë të thatë, ndërsa të dimrit me lagështi. Në komunën e Prizrenit rrjeti hidrografik është relativisht i mirë. Mesatarja e reshjeve atmosferike është 747 mm.

Ndërkaq vet vendi ku është ndërtuar fabrika ish objekt ekzistues dhe vendi ku operon kompania për prodhimin, konzervimine frutave dhe përimeve si dhe prodhimi i keqapit dhe mërmelatës, gjendet në Prizren rruga Tirana p.n Prizren, më saktësisht në ngastrën kadastrale nr. ngastrën kadastrale parcelen me Nr. P - 71813068-06939-0, ne koordinata N 42° 13' 3" dhe E 20° 43' 24", dhe lartesi mbi detare 400 m.



Figura 2. Foto pamje nga lokacioni ku është ndërtuar fabrika për prodhimin, konzervimine frutave dhe përimeve si dhe prodhimi i keqapit dhe mërmelatës (K. Prizren)




Figura 3. Foto, pamje te distancës se lokacionit nga qyteti i Prizrenit.


3.2. Popullata dhe vendbanimet

-Kur është në pyetje procesi i VNM-së, ndër veçoritë kryesore janë edhe popullata, zhvillimet demografike si dhe vendbanimet. Kjo vjen në shprehje për shkak se afërsia e vendbanimeve dhe popullatës ndaj aktiviteteve janë, ndër faktorët kryesor të cilët i ekspozohen ndikimeve në mjedis. Komuna e Prizrenit në bazë të sasisë së ujit është një ndër vendet më të pasura. Kjo pozitë krijon të gjitha parakushtet për zhvillimin e kulturave bujqësore, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe të turizmit. E gjithë kjo ka ndikim në strukturën ekonomike të Prizrenit me rrethin.

Fabrika e lartpërmendur në pikëpamje mjedisore nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në popullatë (zhvendosje), ndërkaq në anën tjetër pritet dhe ka efekte pozitive në aspektin social-ekonomik respektivisht në punësimin e banorëve lokal dhe prodhim vendor.

3.3. Lidhjet e Komunikacionit

- Ngastrën ku ushtron aktivitetin fabrika “ABI&ELIF” sh.p.k, gjendet buzë rrugës e cila të qon ne drejtim te Dragashit dhe me distancë jo të largët me qendrën e qytetit të Prizrenit me qasje të lehtë dhe të pa penguar të lëvizjeve. Nga lokacioni i fabrikës se për prodhimin, konzervimine frutave dhe përimeve si dhe prodhimi i keqapit dhe mërmelatës, ka lidhje shumë të mira komunikacioni si dhe infrastrukturë rrugore e cila e lehtëson transportin e nevojshëm për ushtrimin me sukses të kësaj veprimtarie, pasi qe përveç pozitës se mirë të lokacionit, ka afër erdhe rrugën qe lidhet me vënde tjera. Në largësi prej 5 km nga objekti i fabrikes ne fjale, kalon rruga e autostrada Prishtinë – Prizren po ashtu ka afer rreth 500 meter rrugen magjistrale Prizren-Gjakove dhe rruge tjera e cila është një lidhje e mirë komunikimit rrugor ka mundësuar funksionimin dhe rritjen e afarizmin në biznese e sidomos pas periudhës së tranzicionit në momentet kur filloj procesi i zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla.






Figura 4 dhe 5 Rrugët e komunikacioni, lokacioni i kompanisë.

3.4. Natyra dhe biodiversiteti

-Llojllojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik në Komunën e Prizrenit dhe peizazhet e shumëllojshme natyrore që janë të shpërndara në komunë konsiderohen si vlera natyrore të trashëgimisë. Zona totale e pyllit si në habitatet më të pasura është rreth 23,570 ha, ku sektori privat i ka rreth 3,897 ha dhe 12,170 ha janë pronë publike.

Bazuar nga të dhënat e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AKMM) respektivisht sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), por edhe sipas observimeve në terren, në afërsi të lokacionit ku gjendet ferma nuk ka zona të mbrojtura. (AMMK-IKMN 2008, 2010).

3.5. Flora dhe vegjetacioni

-Sipërfaqet bujqësore, si sipërfaqet të rëndësishme ekonomike paraqesin bazën të rëndësishme natyrore për Komunën e Prizrenit Gjakovë. Kushtet të volitshme klimatike, sidomos numri i madh i ditëve me diell gjatë sezonit veror si dhe ujitja me anë të pipave

për kulturat lavërtare (speca, domate, patate, bostan, qepë etj.) si dhe kultivimi i pemëve. Sipërfaqet bujqësore përfshijnë një sipërfaqe prej 19.998 ha dhe sipërfaqet janë të mbjella me këto kultura: gruri, elbi, tërshëra, misri, etj.

Sipërfaqet më pjellore janë rrafshinat e Anadinisë duke filluar prej Krushës së Vogël, Piranë, e Zojz e Medvec, deri te Korisha në veri dhe veri perëndim të qytetit të Prizrenit, e gjerë në Poslisht, Vlashnje, Zhure e Vermicë në jug. Në këto toka më së shumti kultivohen perimet dhe pemët ndërsa në pjesët tjera në sasi më të vogël kultivohen edhe drithërat tjera si grurë, misër. Nga pemët ndryshme më së shumti kultivohen këto produkte: molla, dardha, kumbulla, pjeshka, arra, kajsia etj. Ndërsa nga perimet që kultivohen më së shumti janë: speca, domate, patate, bostan, qepë, pjepër etj.

Livadhet përfshijnë një sipërfaqe të konsiderueshme të komune të Prizrenit, ndërsa kullosat në këtë komunë zënë një hapësirë edhe më të madhe se livadhet. Këto sipërfaqe kanë ndikim në zhvillimin dhe mbajtjen e ekuilibrit të ekosistemit. Sipërfaqet të përgjithshme të përfshira me pyje janë 55-60 % e sipërfaqes së territorit të Prizrenit. Sipërfaqet e pyjeve përbëhen nga bungu, çarri, ahu, dushk, por ka edhe shkozë dhe frashër të zi. Ka sipërfaqe të tokave të zhveshura e në të ardhmen duhet të kushtohet kujdes në pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura të komunës. Me këto masa do të forcohet funksionimi i pyjeve në procesin e mbrojtjes së mjedisit (ambientit), në stabilitetin për formimin e kushteve klimatike që do të mundëson për rekreacion. Funkcioni i pyjeve është mjaftë me rëndësi për mbajtjen e ekuilibrit biologjik-ekologjik të këtij territori.

3.6. Fauna

-Për gjatë territorit dhe komunës së Prizrenit rrjedhin shumë lumenj si, Drini Bardhë, Lumëbardhi i Prizrenit, lumi Toplluha, si dhe shumë përroje dhe proçkat të cilët derdhen në këta lumenj që ka rëndësi të madhe ekonomike dhe në të gjenden numri i madh i llojeve të peshqve. Në Drinin e Bardhë ka më së shumti bërcak mustak, rapuli, marule, krap, gjal dhe trofta e cila lajmërohet kohë pas kohe. Përafërsisht llojet e njëjtë të peshqve ndodhen edhe në lumenjtë tjerë të komunës së Prizrenit.

Përpos peshqve ka edhe bretkosa, gaforre dhe gjarpinj të ujit. Ndërsa në ekonominë familjare kultivohen gjedhet, kuaj, dele, dhi, derra si dhe shpezë.

Në territorin e komunës së Prizrenit sidomos në zone të maleve të parkut Kombëtar "SHARRI", janë prezentë edhe shtazët e egra si që janë : dhelpira, ujç, lepuj, derri i egër, arinj, drerë, dhi të egra, etj, po ashtu në këtë park ka edhe shumë fruta të egër si: Boronica, mjedra, gështenja, thana, molla dhe dardha të egra, etj po ashtu edhe një numër i madhe i bimëve shëruese si dhe po ashtu edhe një numër i konsiderueshëm i llojeve të kërpudhave.

Shpezë në territorin e komunës së Prizrenit, që janë më të njohura janë këto: thëllëza, sorra, harabeli, pata e egër, korbi, bylbylat, pëllumbat, kumria (Gugutka), skifteri (gjeraqina), shqiponja, pulat e egra dhe lejleku gjatë stinës verore e posaçërisht përgjatë rrjedhjes së lumit Drini Bardhë.

Gjendja e tanishme e ekuilibrit biologjik-ekologjik të komunës së Prizrenit ka kushtet të përshtatshme për zhvillimin florës dhe faunës e cili do të vinte edhe më tepër në shprehje më rritjen e sipërfaqeve me pyje të llojeve të ndryshme të drunjtë, rruajtjen e gjendjes ekzistuese të peshqve dhe begatimi i tyre, kjo vlen edhe për llojet të ndryshme të shpezëve dhe egërsirave të cilat i ka ky territor.

Sipas gjendjes faktike në terren, parcela në zonën ku është ndërtuar dhe ushtron aktivitetin e vetë fabrika për prodhimin, konzervim të frutave dhe përimeve si dhe prodhimi i keqapit dhe mërmelatës, nuk ka ndikim në faunë dhe ndikime tjera që do të ishin në dëm të gjithë atyre gjallesave që jetojnë në atë zonë si; peshqit bretkosa etj.

3.7. Peizazhi

-Peizazhi, paraqet një nga veçoritë e rëndësishme të cilat duhet trajtuar në kuadër të vlerësimit të ndikimeve në mjedis. Edhe pse si definicion, paraqet një tërësi të elementeve natyrore, me vlerë vizuale dhe relaksuese, që d.m.th. në kuptimin e ndotjes dhe emisioneve nuk paraqet efekte direkt në shëndet, megjithatë kjo duhet trajtuar dhe vlerësuar me kujdes.

Rajoni i Prizrenit ka një nder peizazhet më të mira në Republikën e Kosovës, me vendin më të ulët me lartësi mbi detare në Kosovë që është rreth 275 metër mbi nivelin e detit e cila ndodhet në Vermicë, e cila ndodhet në jug-perëndim të qytetit të Prizrenit si

dhe me vargmalet e Sharrit me lartësi mbi detare rreth 2500 metër mbi nivelin e deti, te cilat shtrihen nga lindja deri ne jug te qytetit, prandaj kjo edhe bën qe qyteti edhe rrethina

e Prizrenit te ketë një peizazh shume te mire me bukuri te shumta natyrore. Këtu vlen te përmendët edhe Kalaja e Prizrenit dhe shume monumente tjera historike qe ndodhe ne këtë qytet por edhe ne rrethin.

Ndërsa, siç është përshkruar më lartë, lokacioni i projektit për prodhimin, konzervimine frutave dhe përimeve si dhe prodhimi i keqapit dhe mërmelatës, lartpërmendur, është një lokacion i përshtatshëm për këtë aktivitet dhe do te sjellë anë pozitive.

4.0. KARAKTERISTIKAT HIDROLOGJIKE

- Territori i Prizrenit karakterizohet me një relief të rrafshet me ndryshime të vogla morfologjike të cila kanë ndikuar edhe në formimet linqenore. Terreni ka shtrirje me gjatësi Veri- Jug ndërsa me gjerësi Juglindje-jugpërendim. Hulumtimet në këtë terren nga aspekti hidrogjeologjik dhe gjeomorfologjik janë përshkruar nga autor të ndryshëm të cilët kanë paraqitur karakteristikat hidrologjike dhe hidrogjeologjike të pellgun të lumit Drini i Bardhë. Pjesa e tërësishme e këtij territori përbëhet nga sedimentet e pliocenit, sedimentet e reja të kuaternarit, të teracave lumore të lumit Drini i Bardhë dhe kushteve të cilat kanë mbizotëruar në epokën liqenore të formimit të këtyre formacioneve. Duke vështruar hartën topografike dhe hartën hidrogjeologjike të zonës së gjerë në ultësirës, nga pjesa veriore të zonës i përket zonë jugore të ultësirës së Dukagjinit në mes njësisë se vargmaleve te bjeshkeve te Nemuna dhe fillim të njësie tjetër morfologjike veri - lindje rrafshin e Kosovës.

Lokacioni në te cilin e ushtron veprimtarine fabrika e qumeshtit "ABI"sh.p.k, eshte i vendosur ne pellgun e Drinit te Bardhë . Pelgu i Drinit te Bardhë perveq ujrave te Lumit Drini Bardhë mbledhë me vete edhe ujërat e Lumit Istogu, Klina, Lumbardhit te Pejse, Deçanit, Prizrenit, Lumit Erenik, Toplluha, Mirusha dhe procka tjera me te vogela. Pellgu i Drinit te Bardhë eshte pellgu me i madhe me madhesia e siperfaqes ujembledhese ne Kosova.

Pika koordinative e pusit; **N 42° 13' 3" dhe E 20° 43' 24"**,




Figura.6. Harta topografike e Lokacionit të fabrikës " ABI&ELIF" sh.p.k

4.1. RRJETI HIDROGRAFIK

Lumi më i rëndësishëm për nga ujë rrjedha në këtë regjion është Dini i Bardhe dhe Lumbardhi i Prizrenit. Ujë rrjedhat e këtij regjione drenojnë/shkarkohen në Lumbardhin e Prizrenit e me as ne Drinin e Bardhë të cilët shkarkohet në pellgut ujëmbledhës të Drinit. Të gjitha ujë rrjedhat që drenojnë në pellgun e Lumit të Drini i Bardhë kanë përfundimin e shkarkimit në Detin e Adriatik. Sipërfaqja e pellgut të Lumit Sitnica është prej 279 km², pellgu i Drinit te Bardhë ka nje sipërfaqe prej 4,646 km².

Zone ku eshte vendosur fabrika për prodhimin, konzervimine frutave dhe përimeve si dhe prodhimi i keqapit dhe mërmelatës "ABI&ELIF" shpk nuk është e pasur me burime të medha te ujerave nëntokesore por edhe burimet sipërfaqesore gje e cila eshte e shprehur dhe mund te thuhet per komplet zonen afer rrjedhave te lumenjeve te ketij pellgu.




Figura.7. Rrjeti hidrografik




Figura.8. Siperfaqet e ujerave, rrjeti hidrografik i lokacionit të hulumtuar dhe burimet ujore

4.2 KARAKTERISTIKAT KLIMATIKE

Rrafshi i Prizrenit gjendet në lartësi mbidetare rreth 400 metra dhe disa maje të Sharrit kalojnë lartësinë 2000 metra të lartësisë mbidetare. Klima e qytetit është e llojlojshme. Nga shuma e përgjithshme e reshjeve që bie në territorin e Kosovës, në rajonin e Dukagjinit bien rreth 800 mm në 1 m² të sipërfaqes. Me rrjedhen e lumit rreth 40 % është

mbetje (fundërrine), përderisa rreth 60 % avullohet. Sasia e ujit që derdhet në lumenj është më e madhe në fund të vjeshtës dhe të pranverës, dhe më e ulët në verë dhe dimër.

Prizreni në përgjithësi ka një topografi të valëzuar ku lartësia mbidetare sillet prej 300 m - 2600 m. Përderisa qyteti i Prizrenit ndodhet në sipërfaqen e rrafshët, topografia kodrinore vërehet në pjesën perëndimore dhe lindore të komunës. Lartësia mbidetare e qendrës së qytetit është 400 m (Harta 1.1). Koordinatat e Prizrenit janë 42° 00' dhe 20° 20' veri dhe 20° 30' dhe 21° 00' Lindje. Pozita gjeografike e Prizrenit ofron kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, industrinë e ushqimit dhe turizmin. Temperatura mesatare vjetërore

është 19.1°C. Në verë, kushtet klimatike janë mjaft konsistente dhe precipitimi ndodh herë pas herë ndërsa në dimër kemi të reshura ekstensive. Në vjeshtë vërehen temperaturat më të larta se në pranverë. Mesatarja në vjeshtë është 17.6°C. Në 60% të vitit, temperatura është me e lartë se 0°C pra nuk ka ngrica gjatë 229 ditëve.

4.3 RESHJET

Tek pasqyra e reshjeve, në studimet ekzistuese është shikuar perioda 1948-1986. Reshjet janë element apo faktorë shumë i rëndësishëm për zhvillimin e hidroekonomisë, duke përfshirë debitin e ujërave nëntokësor. Së bashku me sasinë e reshjeve, shpërndarjen e reshjeve brenda vitit reshjet ndikojnë në nivelin e përfitimit të rrushit në vreshtari. Reshjet në dimër depërtojnë thellë në tokë duke mundësuar më shumë ujë të depozituara në nën-shtresa të tokës. Ujërat e dëborës së shkrirë dhe ujërat e reshjeve depozitohen brenda një thellësie të caktuar të tokës, ku rrënjët e rrushit mundë të arrijnë dhe janë jashtëzakonisht të rëndësishëm në aspektin e përmbushjes së nevojës së ujit për vreshtari sidomos pas një vere të thatë. Në Prizren, sasia e reshjeve është më e lartë në dimër dhe në përputhje me shpërndarjen e reshjeve.

Muajt	Reshjet Mesatare mm	Sasia absolute maksimale mm	Sasia absolute minimale mm	Maksimumi absolut ditor
I	50.4	103.1	3	38.7
II	47.6	83.6	14.6	25.9
III	46.5	134.6		31.2
IV	53	97.3		50
V	81.3	170	26.2	92.4
VI	58.3	107.7	18	42.5
VII	51.5	105.2	0.2	49.4
VIII	48.2	145.7	5	52.4
IX	41.7	117.2	10.8	46.7
X	68.3	133.5	0.3	48
XII	72.6	133.5	15.2	60.1
XII	53.9	162.4	12.9	36
Vjetore	673.3	911	466.4	92.4
Dimri	151.9			
Pranvera	180.8			
Vera	158			
Vjeshta	182.6			
Për. Vegje	334			




Tabela.5 dhe 6 Reshjet mesatare mujore - stacioni i matjes në Prizren

Mesataret mujore dhe vjetore të precipitimit në territorin e Prizrenit në mm (R) (1951-1980)													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Mesatare vjetore
R	71	57	59	60	75	59	59	41	60	65	88	77	769
h>0.1mm	12	11	12	12	14	11	12	7	9	8	13	13	134
h>10.0mm	2	2	2	2	2	2	2	1	2	2	3	3	25

Tabela.7. Janë të paraqitura reshjet ekstreme (maksimale dhe minimale) vjetore për stacionin në Ferizaj.




Figura.9.Harta e reshjeve

Gjatë periudhës (1948-1999), vërejmë një shpërndarje normale të reshjeve sipas muajve dhe stinëve të vitit, kështu sasia mesatare vjetore e reshjeve gjatë kësaj periudhe ka qenë 698.9 mm, muaji me më shumë reshje është Shtatori me 73.5 mm dhe Nëntori 59.4 mm, ndërsa Janari me 36.3 dhe Shkurti 39.2 mm janë regjistruar më pak reshje. Periudha 2001-2011 karakterizohet me sasi më të lartë të reshjeve vjetore (736 mm) apo 98.1 mm (12.4%) më shumë sesa gjatë periudhës paraprake, dallimet më të theksuara janë gjatë muajve të vjeshtës dhe të dimrit, të cilat karakterizohen me më shumë sasi të reshjeve, ky faktarsyetohet ngase gjatë muajve të dimrit sidomos Dhjetor-Janar ka pasur më shumë reshje të shiut sesa borës.

4.4 BORA

Shfaqja e borës, kohëzgjatja e mbulesës së borës dhe lartësia e saj, janë paraqitur përmes shtjellimit të të dhënave vrojtuese në stacionet Prizren. Këto të dhëna nuk janë të vetmet stacione ku është bërë vrojtimi i këtyre dukurive meteorologjike, por ato janë me të dhënat më të kompletuara dhe me periudha më të gjata të vrojtimit. Pavarësisht këtij numri të stacioneve të paraqitura, të dhënat mbi borën të cilat janë mbledhur në to, mund të japin një pasqyrë të numrit të ditëve me borë, lartësisë dhe kohëzgjatjes së mbulesës së borës në

tërë territorin e Republikës së Kosovës. Nga të dhënat për numrin e ditëve me borë mund të konstatohet se mesatarja vjetore e borës është 25 Prizren. Megjithatë, pavarësisht nga konstatimet e mëparshme bazuar në të gjitha vërtetimet mund të vlerësohet se numri i ditëve me borë ndryshon me lartësi. Mesatarisht bora fillon me ra në Nëntor (20.XI), dhe pushon së rami në fillim të Mars (15.IV), duke potencuar, që këta kufi ndërrohen me lartësi. Muaji Janar është më i frekuentuari për ditë me borë në të gjitha stacionet matëse, pastaj vite muaji shkurt.

4.5 TEMPERATURA E AJRIT

Regjimi i temperaturave të ajrit për rajonin e analizuar, do të qitet të dhënave nga Fushë Kosovë, për të cilat disponohet me vërtetime. E qartë është se për rajonin e Prizrenit në lokacionin ku operon Fabrika për perpunimin e qumështit, duke pas parasysh pozicionin gjeografik, mund të priten diç regjim i temperaturave më të ultë dhe i temperaturave kontinentale. Në grafikun 2 në vijim, janë të paraqitura vlerat mesatare mujore dhe vjetore të temperaturave për Fushë Kosovë .




Tabela.8. Temperaturat e ajrit.

Temperatura mesatare është 19.1⁰C muaji më i ngrohtë është Korriku me temperatur mesatare t = 22.2 ⁰C. muaji me temperaturë më të lartë është Gushti me 39.2 ⁰C. Amplituda me ekstreme për këtë përvendje është 61.3 ⁰C. Për jetën e përditshme ka rëndësi lagështia relative e ajrit që paraqet shkallën e ngopur të ajrit me avull të ujit. Varësisht nga temperatura e ajrit varet edhe lagështia relative e ajrit. Në temperatura me të larta të ajrit

ka kapacitete të pranoi me tepër lagështi. Në tabelën 3 janë paraqitur lagështia mesatare relative dhe për disa qytete të rajonit të Kosovës.

Mes	1.0	6.4	8.0	11.7	16.1	20.0	23.1	22.6	19.9	12.8	5.7	3.7
Min	-3.4	-0.4	-0.1	-0.5	9.9	13.1	17.9	16.8	14.3	7.4	-3.2	-2.9
Dita	18	6	24	1	7	2	18	6	29	22	28	2
Max	8.5	13.9	14.4	18.6	28.8	25.1	27.8	26.5	24.0	21.0	13.7	12.3
Dita	29	26	13	19	15	29	30	4	1	5	3	25
Std	3.6	3.6	3.6	4.5	4.7	3.1	2.7	2.2	2.7	3.7	4.9	3.8

Tabela.9.Lagështia mesatare e ajërimit

4.6. ERËRAT

-Erërat me drejtimet e lëvizjes dhe shpejtësinë e tyre janë faktor i rëndësishëm në formimin e kushteve të jetës, por edhe në përcaktimin e ndikimeve mjedisore. Lokacioni i seperacionit të granulateve, karakterizohet kryesisht me erëra nga drejtimet siç janë e veriut (13,8 %), veri-lindja (36.2%), dhe perëndimi (31 %), ndërsa më së paku fryjnë erëra e lindjes (11 %), jugut (6 %) dhe jug-lindja (2 %).

5.PËRSHKRIMI I OBJEKTIT DHE INFRASTRUKTURA

5.1. Objektivat dhe infrastruktura

-Fabrika e për prodhimin, konzervimine frutave dhe përimeve si dhe prodhimi i keqapit dhe mërmelatës, "ABI&ELIF" sh.p.k, me aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të këtyre produkteve operon që nga viti 2013 duke ushtruar këtë veprimtari.

Përshkrimi i saktë i aktivitetit të fabrikës për prodhimin, konzervimine frutave dhe përimeve si dhe prodhimi i keqapit dhe mërmelatës, me objekte shoqëruese të nevojshme që janë ndërtuar për këtë aktivitet e që janë:

- ✓ Vija e procesit teknologjik
 - ✓ Ruajtja dhe deponimi i frutave dhe përimeve
 - ✓ Parkimi
 - ✓ Magazina e depozitimit të lëndës së parë
 - ✓ Zyret
- Objektet e cekura me lart janë të karakterit ndërtim i fortë dhe një pjesë mëtalike dhe bëhet fjalë për objekt ekzistues si dhe zyret janë konstruksion i përhershme me material ndërtimor-konstruksion betoni. Procesi i prodhimit të produkteve përfshin

deponimin e lëndës së parë si dhe me grumbullimin e frutave dhe përimëve për procesin e rrumbullakimit me pajtime përcjellëse si në vijim bashkëngjitur gjeni fotot:





Foto nga 1 deri 6 pasqyrojnë pajisjet dhe makineritë e fabrikës "ABI&ELIF" sh.p.k".

5.2. ZBATIMI I RREGULLAVE TË SIGURIMIT TEKNIK, HIGJENËS DHE MBROJTJES SË MJEDISIT



Figura.10.Rregullat e higjenës dhe mbrojtjes së mjedisit

Gjatë përpunimit të pemëve mbajtja e higjienës është njëra prej kushteve më kryesore për një punë të rregullt dhe normale. Pastrimi dhe dezinfektimi i vendit, mjeteve të punës dhe ambalazheve duhet të bëhet para fillimit të punës. Po ashtu edhe higjiena vetjake duhet të jetë në nivelin e duhur. Prodhuesi çdo herë duhet ti lajë duart para fillimit të punës, pasi që gishtat janë në kontakt të vazhdueshëm me të gjitha pajisjet dhe lëndën e parë. Veshja duhet të jetë e pastër, e rregullt dhe e përshtatshme që e mban temperaturën e trupit në nivel të qëndrueshëm.



Figura.11.Rregullat e higjenës dhe veshjës

Pemët po ashtu duhet larë në mënyrë të duhur pasi që mikrobet sulmojnë cipën e dëmtuar të pemëve me ç rast ato konsumojnë pjesët më të mira të tyre Për dezinfektim shfrytëzohen materie të cilat kanë aftësi të zhdukjes së mikroorganizmave dhe që janë të parrezikshme për njeriun. Po ashtu ato duhet të jenë lehtë të tretshme në ujë. Në industrinë e përpunimit të pemëve zakonisht përdoren preparatet në bazë të klorit, fenolit dhe disa baza dhe acide. Preparatet në bazë të klorit më së shpeshti përdoren për dezinfektimin e ujit, dezinfektimin e vendit dhe mjeteve të punës. Si preparate kimike më të njohura janë:

- detergjentet bazike: soda kaustike, karbonet sodiumi, karbonet natriumi etj,
- detergjentet acidike: acidi klorhidrik, fosforik, tartrik etj,
- preparatet sipërfaqësor aktiv-kation, anion dhe të pa disosuar.

6.0. PROCESI TEKNOLOGJIK

Lëndët ndihmëse janë ato pa të cilat nuk mund të përfitohen produkte të gatshme me tregues të caktuar organoleptik, fiziko- kimik dhe qëndrueshmëri. Te tilla janë: uji, sheqëeri, faqoli (glukoza), pektina, uthulla, acidet, caji, lëndët aromatike etj.Uji. Në industrinë e konservimit uji përdoret për disa qëllime: për larjen e frutave e perimeve dhe ambalazhit, për kaldaja, për larjen e mjediseve të punës, për zierje, ftohje, përgatitjen e tretësiravetë ndryshme etj. Uji që është në takim të drejtpërdrejtë me prutat dhe perimet gjatë përpunimit të tyre quhet ujë teknologjik. nga pjesa organoleptike duhet të plotësoj

këto kërkesa: të jetë i tejdukshëm, pa asnjë lloj fundërrie ose turbullirë të lehtë, pa erë dhe shije të huaj. Kërkesa tjetër është fortësia. Në industrinë e konservimit të frutave e perimeve përdoret uji me fortësi nën 10 - 16°Gj. Kur uji është i fortë, gjatë përvëlimit, bishtajoret (mashurkat dhe bizelet e njoma), jo vetëm që nuk zbuten, por humbasin dhe ngjyrën natyrore. Disa fruta nga uji i fortë ashpërsohen. Uji i fortë është i përshtatshëm vetëm për tranguj nga pikpamja higjenike, uji nuk duhet të përmbajë as gjurmë të amoniakut, prania e të cilit dëshmon zhvillimin e proceseve kalbësuese të lëndës organike. Prania e elementeve të ndryshme kimike të tretura në ujë ndikon në treguesit organoleptik të konservave me fruta e perime. P.sh. kalciumi dhe magnezi, nëpërmjet kripërave të patretshme që përftojnë, errësojnë ngjyrën e lëngut të konservave. Metalet e rënda nxitin proceset oksiduese. Kripërat e magnezit, shijen e tyre të hidhur e përçojnë nga uji në produktet e konservuara.

Uji - bakteri logjikisht duhet të jetë i pastër. Të mos përmbajë baktere patogjene, baktere të grupit Coli - Aerogenes dhe baktere kalbëzuese. Sheqeri. Në marmalatë, reçel, konfiturë, pervede etj., sheqeri përbën rreth 50% të lëndës së thatë. Sheqeri duhet të jetë i bardhë, kristalor, me ëmbëlsinë e tij karakteristike, pa erë të huaj, të mos ngjitet nëpër gishtërinj, të tretet lehtë në ujë. Tretësira ujore e sheqerit të jetë pa ngjyrë, pa erë dhe e tejdukshme.

Sheqeri - duhet të përmbajë 99,7 - 99,8% sakaroz dhe jo më shumë se 0,20 - 0,30% lëndë jo sheqerore.

Faqoli - përdoret për të penguar sheqerosjen e marmalatës, reçel - konfiturës e pervedesë. Në disa raste zëvendëson edhe sheqerin. Faqoli përgatitet nga nishesteja (amidoni) në këtë mënyrë, fillimisht përgatitet tretësirë ujore e niseshtesë me dëndësi 20 - 20°Be (36 - 38% ...), zihet, pastaj me kujdes hidhet në tretësirë ujore të holluar të acidit klorhidrik. Vazhdohet zierja derisa amidoni të kthehet në glukozë (bëhet prova me jod). Pas zierjes masa e përftuar asnjësohet me karbonat natriumi, kizelgur dhe karbon aktiv (për t'u çngjyrosur), filtrohet, përqendrohet në vakum parat deri në 45 - 50% lëndë të thatë, përsëri filtrohet, dhe së fundi përqendrohet deri në 80% lëndë e thatë. I gjithë ky proces kryhet në

temperaturë 100 - 120°C dhe trysni 0,1 – 0,2 Mpa. Së fundi ambalazhohet. Faqoli ka shije të ëmbël, ngjyrë të bardhë, dhe konsistencë veshtullore.

Pektina - Është substancë e bardhë, amorfe, pa erë e shije. Tretet në ujë në trajtë tretësire koloidale. Pektina ka vetinë e çmuar të xhelimit në prani të sheqerit në mjedis acid. Kjo cilësi shfrytëzohet në përgatitjen e marmalates, reçel – konfiture, pervedesë, për trashjen e lëngut të tyre.

Kripa e gjellës - Përdoret si lëndë ndihmëse me synim të përmirësimit të shijes së konservave të perimeve por qëllimi kryesor i përdorimit të saj është veprimi konservues. Kripa duhet të jetë e bardhë, kristalorë, pa shije të huaj, e thatë (nuk duhet të përmbajë dhe pislleqe tjera), të mos përmbajnë më shumë se 0,2% kripëra të magnezit. Mund të jetë kripë detit (siç përdoret në industrinë tonë ushqimore ose kripë guri.

Uthulla- përdoret në përgatitjen e marinadave, në trajtë tretësire ujore 4 – 10%-she të acidit acetik. Ajo mund të jetë uthull vere, e përgatitur nga verërat me mbi 90% alkool, ose uthull alkooli, e përfituar gjatë fermentimit acetik të alkoolit të holluar. Pavarësisht nga mënyra e përgatitjes, uthulla duhet të jetë e pastër dhe pa mbeturina, me shije të thartë karakteristike, pa erë të huaj, të mos përmbajë alkool metilik dhe kripëra të metaleve të rënda. Për të përmirësuar shijen dhe aromën e turshive, uthullës i hedhim erëza të ndryshme, si piper i zi, sinap, koper etj. Në përgatitjen e konservave me fruta përdoren edhe acide, si citrik, tartirik etj. Roli i tyre është vendimtar në xhelimin e pektinës. Sasia dhe lloji i acidit që do të përdoret, përcaktohet në recepturën e produktit që do të prodhohet.

Vaji - përdoret në konservat me perime. Duhet të jetë i rafinuar, i asnjësuar, pa ngjyrë dhe me aciditet jo më shumë se 0,5% të shprehur në acid oleik.

